




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 178/19**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së AK-Komuna e Prishtinës (KK- Prishtinë) nr. 178 /19, kërkesë për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE N.SH “ViaPrint” me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikali rrugëve-faza II-te 2018”, me nr. të prokurimit: 616-18-9574-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës, më: 28.03.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE N.SH “ViaPrint” me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikali rrugëve-faza II-te 2018”, me nr. të prokurimit: 616-18-9574-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

**II. DISKUALIFIKOHET** OE N.SH “ViaPrint” me seli në Gjilan, me nr. të certifikatës së biznesit: 810265604 dhe nr. fiskal: 600176722, për shkak të falsifikimit të Vërtetimit të ATK-së dhe atë për periudhën kohore prej gjashtë (6) muajve, të njëjtit operator ekonomik ju ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës që nga dt. 10.04.2018 deri me dt. 10.10.2019.

**A R S Y E T I M**

Autoriteti Kontraktues /Komuna e Prishtinës / me dt: 19 shkurt 2019 ka parashtruar kërkesë në OSHP, që të shqyrtohen mundësitë e veprimit konform nenit 99.2 të LPP-së, për diskualifikim dhe marrje të masave ndaj OEN.SH “ViaPrint”.

Konform autorizimit të datës 21.02.2019, me numër protokoll 178/19, të pranuar më datën 22.02.2019, dhe në bazë të shkresave që patëm në diskutim, ju njoftojmë shkurtimisht me propozimin e autoritetit kontraktues / Komuna Prishtinë, të pranuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), më datën 21.02.2019, kërkesën për diskualifikim nga proceset e prokurimit Operatorin Ekonomik: N.SH “ViaPrint”- Gjilan, përkatësisht zbatimin e nenit 99.2, të LPP-s.

Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, më datën 16.12.2018, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve - faza II-të 2018”, me nrprok 616-18-9574-5-2-1.

Sipas arsytimit të kërkesës për zbatim të nenit 99.2, të LPP-s, potencohet se Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, më datën 06.02.2019, ka kërkuar nga OE NSH “ViaPrint”, vërtetimin në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, përderisa i njëjti Operator Ekonomik më datën 11.02.2019, ka dorëzuar dokumentet në formë fizike në Autoritet Kontraktues: Vërtetimin tatimor të Administratës Tatimore të Kosovës dhe vërtetimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Ekonomik, rrjedhimisht komisioni i vlerësimit të ofertave ka konstatuar se vërtetimi i Administratës Tatimore të Kosovës është i falsifikuar, prandaj Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, zbatimin e nenit 99.2, të LPP-së, kundrejt Operatorit Ekonomik N.SH “ViaPrint”- Gjilan, pasi që i njëjti ka paraqitur të dhëna të rreme dhe në kundërshtim me nenin 65, të LPP-së.

AK - Komuna Prishtinë ka bashkangjitur shkresat (kopje) të përshkruara si më poshtë:

- Kërkesa për zbatim të nenit 99.2, e datës 19.02.2019
- Vërtetimin tatimor të ATK-s, të datës 08.02.2019, në emër të N.SH. “ViaPrint” dhe
- Njoftimin për kontratë për AP me nr. 616-18-9574-5-2-1.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 28.03.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, raporti kronologjik i ekspertit shqyrtues i datë: 28 shkurt 2019 dhe të gjithëparashtrësat e palëvendëprocedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-së z. Sallahudekloroj: ne me dt 06.02.2019 kemi kërkuar nga OE "VivaPrint" që të sjell vërtetimin tatimor për kërkesat e përshtatshmërisë i cili është propozuar për dhënie të kontratës Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal i rrugëve faza e 2 me nr të prokurimit 616-18-9574-5-2-1 nga OE "VivaPrint" me date 11.02.2019 është sjellë dokumentet meqë rast AK pas verifikimit të hollësishëm të dokumentit tatimor përmes portalit të ATK-se ku kemi dhen nr Serik të vërtetimit tatimor meqë rast kemi vërejtur falsifikim të dokumentacionit e cila është e dënuar edhe me kod penal të Republikës së Kosovës. Ne si AK kemi iniciuar kërkesën për sanksionimin administrativ të OE "VivaPrint" që të ju mohohet e drejta për një periudhë 1 vjeçare që ti ndalohej konkurrimi në KK Prishtinë. Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: kërkojmë të sanksionohet administrativisht.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE-së z. Imeri deklaroj: Sa i përket vërtetimit tatimor në e kemi një marrëveshje me ATK 23.04.2018 për shlyerjen e borxheve të prezantuar panelit marrëveshjen dhe pas kërkesës së AK-së ne kemi dorëzuar vërtetimin me 12.08.2018 por edhe një tjetër e kemi dorëzuar me date 14.02.2019. Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë që të refuzohet kërkesa e AK-së .

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, analizës konkrete, deklarimit të palëve në procedurë, sqarimeve të dhëna nga AK KK Prishtinë , diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi ,konstaton se është e bazuar kërkesa e AK-KK Prishtinë për diskualifikim të OE N.SH "ViaPrint" me seli në Gjilan për faktin se operatori ekonomik në fjalë nuk ka arritur të ofroj prova bindëse para panelit shqyrtues për të vërtetuar se Vërtetimi i ATK-së, me të cilin operatori ekonomik në fjalë e ka ofruar në AK KK Prishtinë nuk është i falsifikuar .

---

Paneli shqyrtues, sqaron se AK me dt 06.02.2019 ka kërkuar nga OE N.SH. "VivaPrint" Gjilan, i propozuar për dhinë të kontratës që të sjell vërtetimin tatimor për kërkesat e përshtatshmërisë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal i rrugëve faza e 2 me nr të prokurimit 616-18-9574-5-2-1. OE "VivaPrint" me date 11.02.2019 ka sjellë dokumentet meqë rast AK pas verifikimit të hollësishëm të dokumentit tatimor përmes portalit të ATK-së ku kanë dhen nr. Serik të vërtetimit tatimor kanë vërejtur falsifikim të dokumentacionit, andaj duke pas parasysh faktin se dëshmi e cekura si më lart vërtetohet se janë të falsifikuara dhe se OE ankues nuk ka arritur të provoj të kundërtën para panelit shqyrtues, në rastin konkret OSHP-ja është e autorizuar që ndaj OE NSH "VIVA PRINT", të merr masa në pajtim me LPP-në, pra OE në fjalë ta diskualifikoj nga pjesëmarrja në aktivitetet të

prokurimit nënjë periudhe prej (6) gjashtë muajve.

Paneli shqyrtues për kërkesën e datës 19.02.2019, të AK KK Prishtinë të parashtruar kundër OE N.SH. “VIVA PRINT” Gjilan vepron në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, në të cilin nën thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Paneli shqyrtues konform nenit 99.2 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK –Komuna e Prishtinës

1x1 OE N.SH.“VIVA PRINT”

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së